

PROCEDURA QË DO TË NDËRMARRË APLIKUESI PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJEVE
HIDROKARBURE ME ALBPETROL

1. Ministria e Infrarstrukturës dhe Energjisë publikon në faqen zyrtare interesin për të lidhur marrëveshje hidrokarbure me palët e interesuara për vendburimet e lira (rasti konkret për Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj, Amonicë).
2. Albpetrol sh.a. në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr.150 datë 06.02.2018 publikon në faqen e internetit formularin e aplikimit, kushtet dhe termat kryesore, hartën e vendburimeve të lira si dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit.
3. Albpetrol sh.a. harton paralelisht dhe paketën e të dhënave kryesore bazë të vendburimeve dhe shpjegon për aplikuesit dhe mënyrën e përfitimit të tyre, përkundrejt një procesi të thjeshtë, të hapur dhe transparent.
4. Brenda 10 ditëve nga afati i fundit të dorëzimit të aplikimeve, Albpetrol sh.a. dërgon në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë gjithë dokumentacionin e aplikuesit dhe kërkesën për fillimin e negociatave (ne rastin kur është vetëm një aplikues). Në qoftë se janë më tepër se një aplikues, atëherë Albpetrol sh.a. dërgon gjithë dokumentacionin e aplikuesëve së bashku me vlerësimet e kapaciteteve teknike dhe financiare të tyre. Gjithashtu Albpetrol sh.a. dorëzon dhe termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes hidrokarbure.
5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë brenda 7 ditëve nga marrja e dokumentacionit të shoqërive aplikuese jep miratimin ose jo të shoqërise fituese.

6. Në rast të miratimit të shoqërisë fituese, Albpetrol sh.a. fillon negociatat me subjektin fitues për termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes hidrokarbure.
7. Pasi palët bien dakort mbi termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes hidrokarbure, dokumenti nënshkruhet nga palët dhe brenda 10 ditëve përcillet në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për miratim.
8. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë brenda 10 ditëve miraton ose jo termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes hidrokarbure.
9. Brenda 20 ditëve nga marrja e miratimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të termave dhe kushteve kryesore të marrëveshjes hidrokarbure, Albpetrol sh.a. fillon negociatat me shoqërine fituese dhe dërgon për miratim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentin e firmosur në cdo faqe brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i tij.
10. Në qoftë se drafti i paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duhet rishikuar, atëherë ai do të ridërgohet në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë brenda 20 ditëve mbas oponencës së tij.
11. Drafti i miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të dërgohet për oponencë pranë Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, të cilat në qoftë se kanë ndryshime i dërgojnë ato brenda 20 ditëve.
12. Drafti përfundimtar dërgohet në Albpetrol sh.a., ku brenda 10 ditëve autorizohet të nënshkruajë marrëveshjen hidrokarbure me aplikuesin fitues.

13. Marrëveshja hidrokarbure e nënshkruar nga palët përcillet në Kryeministri për miratimin përfundimtar të saj.

PËR PAJISJEN ME LICENSË MARRËVESHJE NGA ALBPETORL SH.A.

1. Albpetrol sh.a. 10 ditë mbas miratimit të termave dhe kushteve kryesore të marrëveshjes hidrokarbure, dërgon një kërkesë pranë AKBN-së për tu pajisur me licensë marrëveshje për vendburimet e lira.
2. AKBN brenda 30 ditëve dërgon në Albpetrol sh.a. draftin e licensë marrëveshjes, i cili do të diskutohet brenda afatit kohor të 50 ditëve nga data e dorëzimit.
3. Drafti përfundimtar dorëzohet për miratim pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i tij.
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë miraton ose jo draftin përfundimtar brenda 10 ditëve. Në rast se do të kërkohen rishikime, ato do të kryhen brenda 30 ditëve nga marrja në dorëzim për rishikim dhe drafti i rishikuar paraqitet për miratim. Ky dokument nënshkruhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Albpetrol sh.a. brenda 10 ditëve pasi është dhënë miratimi për marrëveshjen hidrokarbure.